

№. 4297
180/62

PËRPARIMI

Reviste kulturore

NUMRI 5

Shtator 1955

VJETI I

ANTARËT E REDAKSIS:

Ismet Shaqiri, Hiozi Sulejmani, Vojislav Dancetoviqi, Elhami Nimani,
Mehmet Hoqha, Stathi Kostari, Abdullah Zajmi, Mehmedali Hoqha, Lo-
renc Antoni, Mehdi Bardhi, Xheladin Topçiu, Ali Rexha, Mark Krasniqi,
Jusuf Shushka, Hasan Vokshi, Ismet Mula, Shevqet Veliu,
Masar Murtezai

KËSHILLI REDAKTUES:

Mehdi Bardhi, Stathi Kostari, Ali Rexha,
Xheladin Topçiu, Hasan Vokshi, Jusuf Shushka

DREJTORI PËRGJEGJËS

Elhami Nimani

PËRMBAJTJA:

PAJAZIT NUSHI

Transfera në procesin e të mësuesit

DËRVISH ROZHAJA

Darvini reformator i biologjis dhe parimet e tij mbi
evolucjonin

HASAN KALESHI

Gramatika shqipe e Fazil Tiranasi

KADRI HALIMI


Etnologjija, etnografija dhe folklori

BOSILKA BELLOSHEVIQ

Randësija e lojës për fëmijët e moshës parashkollëre

MIRKO BARJAKTAROVIC

Etiopia dhe Etiopasit



MARRËDHANJET NDËRMJET GJUHËS SHQIPE DHE RUMUNE

Në literaturën shkencore flitet shumë për gjuhën shqipe dhe rumune, qoftë fjala n'albanologji, ballkanologji, romanistikë ose për problemin iliro-thrakas.


Prej kah vjen kjo? Merret vesh se rrjedh prej faktit që dikur gjuha shqipe dhe rumune kanë pasë lidhje shumë të ngushta dhe nga ana tjetër për arsye se gjuha rumune ka randësi të dorës së parë për historinë e gjuhës shqipe si dhe anasjelltas: për arsye se gjuha shqipe ka po aq randësi, ndoshta edhe më të madhe, për historinë e gjuhës rumune. Në të vërtetë ka edhe gjuhë tjera që luejtën rol të randësishëm në zhvillimin e gjuhës shqipe dhe rumune. Për Shqiptarët kanë randësi shumë të madhe po kështu latinishtja, sllavishtja (sërbishtja e maqedonishtja), greqishtja e ré, italishtja dhe turqishtja. Përsëri për Rumunët bullgarishtja (posaçërisht), hungarishtja, rusishtja e tjera. Por, e gjithë kjo në pikëpamje kualitative nuk është njilloj. Kur të flasim për ndikimet latine, sllave e tjera ndër Shqiptarët, ose ndikimin bullgar etj. ndër Rumunët, — atëherë këtu është çashtja e fjalëve (t'ashtuquejtunat „fjalë të marruna hua”) prej atyne gjuhëve që muerrën Shqiptarët e Rumunët, ashtu sikur muerrën këso fjalësh edhe Ballkanasit tjerë. (Jugosllavët, Grekët, Turqit etj.)

Ndërkaq marrëdhënjet gjuhsore shqiptaro-rumune kanë karakter shumë e shumë më të thellë. Kur është fjala për lidhjet linguistike shqiptaro-rumune (natyrisht në të kaluemen), atëherë gjuhtarët specialistë përdorin zakonisht termën **simbiozë**. Me fjalë tjera, sod në shkencë merret si e pakundërshtueshme se Shqiptarët e Rumunët, gjykue posaçërisht në mbështetje të këtyne dukunive gjuhsore, dikur në një të kalueme të lashtë jetuen në njëfarë bashkësije gjuhsore.

Tash del pyetje çfarë bashkësije gjuhsore ka qenë ajo. Që në fillim kuptohet qartë se ajo bashkësi nuk ishte pikrisht, si me thanë, si ajo ndërmjet gjuhës frange, italiane e spanjole; ose gjermane, hollandeze, engleze etj.; ose sërbokroatishte, çe-ose ruse etj. Në këto rasa të fundit luen rol e ashtuquejtuna lidhje gjenetike („farefisnija”). Kështu gjuhët frange, itali-

ane, spanjole — të gjitha sëbashku janë shumë t'afërta në mes tyre, për shkak se që të gjitha zunë fill prej një „âme”, prej gjuhës latine. Po kështu është puna edhe me sërbo-kroatishten, bullgarishten, rusishten e tjera — të gjitha zunë fill prej një gjuhe të vetme parahistorike „paraslllovene”, e kështu me rradhë.

Mirëpo kjo rasë nuk është e njëjtë për Shqiptarët dhe Rumunët. Pse ndërsa rumunishtja është „pjellë” e latinishtes, në parim njisoj si frangjishtja, italishtja e tjera, pra, në një instancë të fundit hyn në grupin oksidental ose **kentum** — të gjuhëve indoevropiane; përkundrazi gjuha shqipe, si „pjellë” e thrakishtes, ban pjesë në grupin oriental ose **satem** -- të



SHEMA A

gjuhëve hindoevropjane, bashkë me sllavishten, armenishten, persishten e tjera. Gjith kjo që thamë mund të paraqitet grafikisht kështu:

Prej shqipes deri te rumunishtja — sikur se shifet — lidhja „gjenetike” është shumë e largtë; praktikisht merret si mos me qenë fare. (Si për shembull, ndërmjet sërbo-kroatishtes e anglishtes ose italishtes e norvegjishtes etj. Por, megjithatë simbioza historike (mâ me saktësi: parahistorike) e gjuhës shqipe dhe rumune është realitet dhe mund të shifet prej këtyre që po rreshtojmë mâ poshtë:

1) Në rumanishte egzistojnë një mori fjalësh të randësishme origjine shqipe, madje mâ shumë se në çdo gjuhë tjetër ballkanike. Ky fakt është i njoftun prej kohësh dhe e përpunoi sistematikisht e në mënyrë të posaçme albanologu gjerman

Carl Treimer. Qe disa shembuj: rum. **mazâre** prej shq. **modhullë**; **brad** prej **breddh**; **sâmbure** prej **thumbullë**; **brîn** prej **brêz**; etj. Analiza tregon se të gjitha këto fjalë dhe shumë tjera si këto Rumunët i kanë marrë prej Shqiptarëve në një kohë shumë të lashtë.

2) Nga ana tjetër në gjuhën shqipe ka shumë fjalë rumunishte, forma e të cilave, për shembull, nuk egziston në frangjishte, italishte e tjera; por vetëm në rumanishte, ose të paktën një kuptim i ngjajshëm fjalësh kësodore origjine latine, gjindet vetëm në shqipe dhe rumunishte. Kjo don të thotë se elementi latin i gjuhës rumune e shqipe — është i ndryshëm prej elementit latin t'italishtes, frangjishtes e tjera, e madje ndryshej prej elementit latin të gjuhës romane në të vdekunën dalmatishte të vjetër. Qe edhe këtu disa shembuj. Kështu „fjala” rumunishte **cuvînt** shqip thuhet **kuvênd** (dhe kjo prej lat. **CONVENTUS**), ndërsa në vend të kësaj italisht thuhet **parola**, frangjisht **parole** e tjera, e madje edhe në dalmatishte të lashtë **palaure** (= lat. **PARABOLA**). Kështu vetëm rumunisht **padure** dhe shqip **pyll** (prej njëj trajte **mâ** të vjetër **pëyll**, po prej njëj trajte edhe **mâ** të lashtë **pëdyel**) (= lat. **PALUDE-M**), që do të thotë „pyll”, kurse në gjuhët tjera romane po kjo fjalë do të thotë („kënetë”): për shembull, ital. **Palude** etj. Po kështu përsëri rum. **Secret** do të thotë njisoj si në shqip shkret (= **SECRETUS**), ndërsa në gjuhët tjera romane do me thanë „msheftë, msheftësi” (ital. **secreto, segreto** etj.). Këso rasash ka edhe shumë tjera.

3) Në gjuhën rumune egzistojnë veti gramatikore që si duket janë marrë prej Shqiptarëve. Kështu, për shembull, simbas Bariqit, ndodh me një postpozitive (shif rum. **om** = **njeri** përkundrejt **omul** = **njeriu**) e tjera.


4) Anasjelltas në fjalët shqipe me origjinë latine çfaqen dukuni gramatikore si n'ate rumanishte. Po kështu ndodh posaçërisht me ndryshimin kaq shumë të diskutuem të lat. **ST** në rum. **pt** (dialektore poashtu **ft**), shqip **ft**. Për shembull, rum. **luptâ** = shqip luftë) prej latinishtes **LUCTA**, ndërsa në gjuhët tjera romane për lat. **CT** gjëjmë një gjâ krejt tjetër (p. sh. ital. **lotta**, etj.) Edhe këso rasash gjinden mjaft.

Si shifet këto lidhje nuk janë vetëm të shumta dhe të llojllojshme, por edhe ç'është **mâ** me **randësi**, janë edhe — të huashme dhe shumë specifike, dhe prej të cilave nxirren logjikisht dy përfundime: 1) gjuha shqipe — ndonse me origjinë në nuk është romane as latine — muerr pjesë në një kohë në

*) **pt** dhe **ft** në të vërtetë janë shumë t'afërta, pse bashkëtinglloret **p** dhe **f**, si njana si tjetra, janë bashkëtingllore buzore të pazashme (shprehun shkencorisht, me termë latine, **tenues labiales**)

zhvillimin e një gjuhe romane, dmth. të rumanishtes; 2) rumanishtja është gjuhë romane, por gjatë zhvillimit të saj — dikur — muerr pjesë në procesin e zhvillimit të një gjuhe joromane, dmth. të gjuhës shqipe. Prej këtyre dy përfundimeve nxirret përsëri një konkluzion tjetër i përgjithshëm dhe i dyanshëm.

Gjuha shqipe përvehtësoi shumë cilsi romane, më saktësisht rumune, por nga ana tjetër atij tipi roman, dmth. rumunishtes i dha shumë forma të saja, dmth. forma joromane. Që, pra, ky është kuptimi i asaj „simbioze” gjuhsore (pra etnike) shqiptaro-rumune.



Nëqoftëse do të dëshirojshim me shënue këte në skemën A, atëherë do të konstatojshim se këto dy gjuhë të largta „gjetnikisht” (praktikisht të hueja për njana tjetrën me origjinë), shqipja e romanishtja hynë, në teren, në marrëdhënie të reja**) (po e tregojmë më thjeshtë):

** Kur këte lidhje e quejmë të *ré*, atëherë kjo dmth. se nuk është primitive, origjinale. Por, megjithatë është shumë e lashtë. Shkenctarët mendojnë se kjo ndodhi para një mijë vjetësh e më tepër, sidoqoftë para ardhjes së Sllavëve.

Derisa këte çashtje e arsytuem kështu teoretikisht e deri diku edhe në mënyrë apstrakte, duhet atëherë me e pasqyrue pak më realisht e më gjansisht.

Si ndodhi kjo lidhje kaq e ngushtë?

Në kohën e shkeljes së Romakëve në Ballkan — afërsisht në pjesën perëndimore të Ballkanit banojshin Ilirët (të cilët këtu nuk na interesojnë), kurse afërsisht në pjesën lindore (përveç Grekëve natyrisht) — Thrakasit. Fiset thrakase banojshin në krahinat e Dakís (Rumanija e sotme), në Bullgarín e sotme, në Sërbín lindore dhe në disa pjesë të Maqedonís. Në këto treva, pra flitej gjuha thrake (dmth. „parashqipja”) Qytetet e këtyne krahinave ja nisën shpejt me folë latinisht. Midis tjerash latinishtja filloi me u përhapë prej qyteteve edhe nëpër fiset thrakase. Kështu aty ku ndikimi latin ishte më i madh — fiset thrakase nisën me e braktisë gradualisht gjuhën e tyre amnore, thrakishten dhe filluen me folë një dialekt „të prishun” latin në të cilin, midis të tjerash, u rrujtën shumë „thrakizme” për shembull, artikulli postpozitiv; fjalët si *mazâre* prej *modhullë* etj. etj.; shiqo më në altë). Kështu lindi gjuha rumune, — romane me shumë elemente thrakase. Përkundrazi aty ku gjuha latinishtë ndikoi më pak (megjithse edhe ky ndikim prap që i madh) — gjuha thrakase, si e tillë, parimisht u rrujt, nuk u „latinizue”, por përsëri përvehtsoi shumë elemente të latinishtes. Ky kombinim gjuhsuer, pra, është shqipja.

Nëse më lejojnë lexuesat, edhe këtu — për me qenë sa më i qartë — këto marrëdhënie kisha me i shprehë në formë të një skeme. Nëqoftëse elementin thrakas e shënojmë me TH, ate latin me L, ate shqiptar me SH dhe ate rumun me RUM, atëherë kishim mrujtë me bënë një kësi barazimi:

$$\begin{aligned} SH &= TH + L \\ RUM &= L + TH \end{aligned}$$

SKEMA C

Shkurt me thanë, gjuha shqipe e rumune në thelb janë krijuar prej së njëjtash komponente, vetëm se në njërin rast është më e fuqishme komponenta autoktone (thrakase) dhe (gjuha mbeti e tipit thrakas), kurse në rastin e dytë është më e fuqishme komponenta ardhëse (latine) dhe (gjuha e humbi tipin thrakas dhe u bë romane).

Kuptohet vetëvetiu se proceset e vërteta nuk duhet me i marrë kështu të thjeshtësueme. Në vetëvehte ato qenë mjaft të ndërliqshme, por këtu deshtëm me paraqitë idën themelore të atyne proceseve. Sikurse shifet, kur flitet për bashkësin

gjuhsore të Shqiptarëve dhe të Rumunëve, dhe kjo me asnjë mënyrë nuk bâhet pa njifarë shkaku real, e madjë të rrastë, për arsye se sod si njanën ashtu tjetrën gjuhë; përshkojnë thellësisht të njajta evoluta tashmâ të përjetueme; pa marrë parasysh faktin që me origjinë janë kryekreje të ndryshme e të largta, dhe që janë edhe sod kryesisht kështu të ndame.

Prej këtyneve kuptohet se nuk âsht e saktë edhe pikëpamja mjaft e përhapun: që stërgjyshnit e Shqiptarëve kanë qenë gjoja asimilues të mëdhej të gjanavet të hueja dhe që shum lehtë kanë braktisë të trashëguemen. Natyrisht, Shqiptarët (si shum popuj tjerë t'Europës) përvehtsuen shum të hueja, por liparet themelore të gjuhës së tyne i ruejtën deri në ditët e sodit.

Po cekim shkurt edhe çashtjen gjeografike t'asaj simbioze të lashtë, parahistorike, thrako-romane (dmth. shqiptaro-rumune) në Ballkan. Tue gjykue mbas emnave gjeografikë, nga një anë, dikurë gjithë Rumanija (Dakija) ishte sllave dhe nga ana tjetër Sërbija lindore dhe Bullgarija perëndimore banoheshin prej Rumunësh; sod në shkencë mbizotnon pikëpamja se atdheu i Rumunëve gjindej diku në krahinat e Nishit e të Sofjes, ndoshta edhe të Shkupit, e tjera. Nga ana tjetër, emni sërbisht **Nish** prej atij klasik Naissus, për arsye të **Sh-s** në vend të **S-s** tregon se Sërbët këte emën të vjetër e muerrën prej Shqiptarëve. Kësish shembujsh ka edhe mâ. Prej këtyne nxirret një përfundim i sigurtë se pikërisht në këto krahina kufitare të Sërbis, Maqedonis e Bullgaris, bashkë me Thrakasit e romanizuem (dmth. me Rumunët) jetojshin edhe Thrakasë jo të romanizuem (dmth. Shqiptarët) ose, me fjalë tjera, para se Sllovenët të vendoseshin në Sërbí lindore, në Bullgarín perëndimore në Maqedonín veriore — këto vende ishin votra të popullit shqiptar e rumun. Ardhja e Sllavëve shkaktoi gradualisht tërheqjen e popullatës së lashtësis dhe në këte mënyrë rrodhi shprishja e bashkësis shqiptaro-rumune.

Dr. Ivan POPOVIQ